

Tetor 2024

# Buletini



## Parathënie

Mirë se vini në edicionin e parë të buletinit të CNVP Kosova!

Buletini është pjesë e projektit Shfrytëzimi i Qëndrueshëm i Resurseve Natyrore për Mjedis dhe Zhvillim Ekonomik (SUNREED), i financuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë / Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida).

Në Fondacionin Lidhim Njerëzit me Vlerat e Natyrës (CNVP), ne jemi të përkushtuar për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në gjithë rajonin. Ekipi ynë ndan një kulturë organizative të rrënjosur thellë në vlerat e përkushtimit, inovacionit dhe bashkëpunimit.

Ky buletin shërben si një platformë për të ju informuar për iniciativat tona, projektet me ndikim dhe për të promovuar arritjet kryesore duke përfshirë krijimin e marrëveshjeve për partneritete strategjike në të gjithë sektorin, duke synuar rritjen e punësimit, gjenerimit të të ardhurave dhe praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të pyjeve.

Në këtë numër, ju do të mësoni për iniciativat tona aktuale, histori suksesi nga Sektori Pyjor, duke u fokusuar në Produktet Pyjore Jo-Drunore (PPJD), Bimët Mjekësore dhe Aromatike (BMA) dhe prodhimin e biomasës për tregjet e energjisë së rinovueshme, si dhe mënyren si po përmirësojmë zhvillimin organizativ të Shoqatës Kombëtare të Pronarëve të Pyjeve Private (SHKPPP) dhe Asociacionit Kombëtar i Pronarëve të Pyjeve Private (AKPPPK), duke rezultuar në përmirësimin e funksionimit të brendshëm, qeverisjes dhe aftësive avokuese.

Faleminderit që na u bashkuat në këtë rrugëtim teksa ne vazhdojmë të sjellim risi dhe të bashkëpunojmë drejt një të ardhmeje të qëndrueshme.



Me respekt,

*Xhevat Lushki*

Drejtor,  
CNVP Kosovë



## Modele të reja biznesi: Përmirësimi i praktikave të kultivimit të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA)

Në fshatin Terpezë të komunës së Malishevës, bashkëshortët Shefqet dhe Zymrije Krasniqi kanë ngritur një ndërmarrjen AgrosHQiponja, një iniciativë frymëzuese e cila fokusohet në kultivimin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike (BMA) dhe grumbullimin e Produkteve Pyjore Jo Drunore (PPJD). Rritja e AgrosHQiponjes ka filluar që nga themelimi i saj në vitin 2018, duke menaxhuar një plantacion me 10 ari ku kultivohen 14 lloje BMA-ve, duke përfshirë mullagen, menten, rigon, kalendulen, etj, të rritura me kujdes për të fituar vajrat e tyre esenciale dhe përbërësit e tyre mjekësore.

Përveq kultivimit, AgrosHQiponja shquhet edhe për përpunimin, paketimin dhe shpërndarjen e BMA-ve si dhe mbledhjen e produkteve pyjore jo-drunore (PPJD). Inovacionet e fundit të kompanisë përfshijnë nxjerrjen e vajrave esencialë nga bimë si rizoni, livanda dhe sherebela, duke dëshmuar përkushtimin e tyre në ruajtjen e cilësisë përkrah inovacionit në produktet bimore.

Në qendër të suksesit të AgrosHQiponjes është bashkëpunimi i tyre me projektin Shfrytëzimi i Qëndrueshëm i Resurseve Natyrore për Mjedis dhe Zhvillim Ekonomik (SUNREED) të implementuar nga CNVP Kosova. Partneriteti me projektin i ka ndihmuar atyre për të revitalizuar fidanishten e BMA-ve me sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup>, duke përmirësuar izolimin e ajrit dhe nivelimin e tokës për të optimizuar efikasitetin e energjisë dhe për të mbrojtur bimët nga kërcënimet nga moti dhe ndotesit nga toka. Këto përmirësime jo vetëm që kanë rritur vëllimin e prodhimit, por edhe kanë

ngritur cilësinë e fidanëve të tyre, duke i mundësuar AgrosHQiponjes të shpërndajë mbi 800,000 fidanë të BMA-ve tek më shumë se 50 fermerë në rajon.

Si rezultat i kësaj është rritur jo vetëm punësimi dhe profitabiliteti i AgrosHQiponjes por janë fuqizuar edhe grupet e marginalizuara si dhe fermerët në gjithë rajonin e Malishevës. Mbi 30 fermerë tani kanë kontrata për blerjen e fidanëve të BMA-ve, e cila stimulon rritjen e biznesit vendor dhe krijimin e punësimit të qëndrueshëm.

Edhe në të ardhmën, AgrosHQiponja mbetet e përkushtuar për të zgjeruar praktikën e bujqësisë së kontraktuar dhe organike, nëpërmjet mbështetjes dhe ekspertizës së ofruar nga projekti SUNREED.

E ndërsa AgrosHQiponja vazhdon rritjen dhe inovacionin e mbështetur nga këto iniciativa, tregimi i tyre i suksesit përçon besim për gjithë tjerët për ta ndjekur.



*Para (majtas) dhe pas (djathtas) përmirësimit të fidanishtes për BMA dhe PPJD.*

## Fuqizimi i Pronarëve të Pyjeve të Kosovës

Sektori i pasur pyjor i Kosovës luan një rol vendimtar si në ekonominë vendore ashtu edhe në qëndrueshmërinë mjedisore, me pronarët privatë të pyjeve (PPP) që i prijnë procesit të menaxhimit të këtyre burimeve. Duke ditur rolin e rëndësishëm të PPP-ve në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, CNVP përmes projekteve të saj të ndryshme dhe së fundmi përmes projektit SUNREED, vazhdon ngritjen e aftësive të tyre dhe rritjen e perspektives ekonomike.

Asociacioni Kombëtar i Pronarëve të Pyjeve Private të Kosovës (AKPPPK), si organizata ombrellë për shoqatat lokale të PPP-ve, punon në konsolidimin dhe avancimin e sektorit. Me mbështetjen e CNVP-së, AKPPPK ka ndërmarr një ristrukturim të rëndësishëm organizativ, duke rritur transparencën, përgjegjësinë dhe efikasitetin operacional. Gjatë vitit 2023, projekti SUNREED ka ndihmuar me një sërë ndërhyrjesh strukturore përfshirë dhe themelimin e zyrës së AKPPPK-së në Prishtinë, një hap vendimtar për koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve të zgjëruara për PPP-të.

Duke punuar krah për krah me asociacionin kombëtar, CNVP kishte rol vendimtar në ngritjen e aftësive dhe njohurive të nevojshme për PPP-të përmes programeve të saj për ngritje të kapaciteteve. Këto iniciativa të CNVP-së përfshinin zhvillimin e moduleve të targetuara të trajnimit rreth: intervenimeve për kultivimin e pyjeve, mjetet dhe teknologjia pyjore, masat e sigurisë dhe praktikat e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Projekti ka ofruar sesione të shumta trajnimi në mbarë Kosovën, duke trajnuar mbi 150 PPP në rajone të ndryshme të vendit.

Mbështetja e CNVP-së ndër vite e ka fuqizuar AKPPPK të punojë në mënyrë të pavarur dhe efektive në menaxhimin e burimeve pyjore.

## Krijimi i Plantacioneve të Drunjëve me Rritje të Shpejtë në Kosovë

Këtë vit, një grup fermerësh privatë proaktivë arritën një sukses historik në pylltarinë e qëndrueshme duke krijuar një plantacion pemësh me rritje të shpejtë prej 4 hektarësh. Kjo iniciativë, pjesë e projektit SUNREED të CNVP Kosova, u prezantoi fermerëve llojet vendore të bimëve me rritje të shpejtë sikur Plepi dhe Bagremi, të cilat janë të njohura për rritjen e tyre të shpejtë dhe rendimentin e lartë të biomasës, që i bëjnë ato të përshtatshme për prodhimin e energjisë dhe përpunimin e drurit. Partneriteti mes fermerëve dhe një kompanie vendore të përpunimit të drurit siguron furnizim të qëndrueshëm të drurit, me fermerët që kultivojnë plantacionet dhe kompaninë që blen biomasën prej tyre pas një periudhe të caktuar, duke nxitur kështu stabilitetin dhe rritjen e ndërsjellë.

Kalimi në plantacione që kultivojnë pemët me rritje të shpejtë jo vetëm që rrit produktivitetin bujqësor, por gjithashtu siguron kthime më të shpejtë të investimit në krahasim me kulturat tradicionale të drurit. Krijimi i plantacioneve të pemëve me rritje të shpejtë zvogëlon gjithashtu presionin ndaj pyjeve për të furnizuar biomasën për qëllime ngrohjeje. Kjo qasje, e mbështetur edhe nga rritja e shpejtë të Plepit dhe Bagremi, ofron stabilitet financiar dhe parashikueshmëri më të mirë për fermerët, duke siguruar në të njëjtën kohë furnizim të besueshëm të biomasës së drurit për operacionet e kompanisë përpunuese.

Ngritja e suksesshme e plantacioneve fillestare prej 4 hektarësh janë vetëm fillimi, duke krijuar një precedent për projektet e ardhshme. Me maturimin e këtyre pemëve, bashkëpunimi ndërmjet fermerëve dhe kompanisë së përpunimit të drurit do të vazhdojë të japë rezultate. Ky model premtan zgjerim në rajone të tjera, për shkak të potencialit të tij për të ndikuar pozitivisht në ekonominë dhe mjedisin e Kosovës.



## Iniciativa e CNVP-së me Planet e Menaxhimit të Pyjeve për Fuqizimin e Pyjeve të Kosovës

Në ndjekje të praktikave të qëndrueshme të pylltarisë, CNVP po forcon punën e saj në përmirësimin e menaxhimit të pyjeve private në Kosovë. Në qendër të kësaj përpjekjeje qëndron zhvillimi dhe zbatimi i Planeve të Menaxhimit të Pyjeve (FMP).

Një Plan Zhvillimi për Pyjet përcakton aktivitetet e planifikuara pyjore (të tilla si: inventarizimi, llogaritja e rendimentit, vjelja, silvikultura, mbrojtja dhe monitorimi), duke përcaktuar objektivat, veprimet dhe organizimin (aranzhimin) e kontrollit në një zonë pyjore.

Prandaj, objektivi i CNVP është të ndërtojë kapacitete dhe të stimulojë pronarët e pyjeve private (PPP) dhe bizneset që të punojnë së bashku për t'u siguruar që pyjet private funksionojnë sipas planeve të menaxhimit.

Një shembull i dalluar është Hamit Pireva, pronar i pyllit privat (PPP) në Kamenicë. Pylli prej 3 hektarësh i Pirevës nuk kishte pasur asnjë aktivitet kultivues në historinë e tij 35-vjeçare derisa CNVP, përmes projektit të saj SUNREED, bashkëpunoj me kompaninë Feniks-A, një prodhues i shqar i ashklave te drurit dhe peletit.

Feniks-A kishte interes të madh për të bashkëpunuar me PPP si Pireva për të siguruar në mënyrë të qëndrueshme biomasë nga pyjet. Hapi i parë përfshinte kryerjen e një inventarizimi gjithëpërfshirës dhe përgatitjen e planeve të menaxhimit të përshtatura për pyllin e Pirevës. Ky plan përcaktonte ndërhyrjet e nevojshme, duke përfshirë aktivitetet e rrallimit për të optimizuar shëndetin dhe produktivitetin e pyllit.

Pas zbatimit të Planit të Menaxhimit të Pyllit, vazhduan aktivitetet për rrallimin e pyllit të Pirevës. Edhe pse biomasa e mbledhur u konsiderua me cilësi të ulët për përdorime të tjera, ajo ishte e përshtatshme për prodhimin e copëzave të drurit.



Përafërsisht 200 ton biomasë u prenë dhe u transportuan në pikën grumbulluese Feniks-A në Gjakovë, e cila më pas shërbeu si lëndë djegëse për sistemin e ngrohjes qendrore të rajonit.

Bashkëpunimet dhe partneritetet e suksesshme si ai midis CNVP, Feniks-A dhe PFO-ve ilustronë qasjen strategjike në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Kompanitë përfitojnë nga një furnizim i qëndrueshëm dhe i besueshëm i biomasës nga pyjet që kanë plane të përcaktuara për menaxhimin e tyre, duke ofruar në të njëjtën kohë përfitime ekonomike për pronarët e pyjeve private.

Integrimi i FMP-ve jo vetëm që fuqizon pronarët privatë të pyjeve në Kosovë, por siguron gjithashtu menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve pyjore për gjeneratat e ardhshme.

CNVP mbetet e përkushtuar për të zgjeruar mbështetjen e saj për PFO-të dhe për të forcuar partneritetet me liderët e industrisë.